



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:220459

Datë: 01.02.2023

Numri i dokumentit: 03927641

PS.nr.42/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË Departamenti Special trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët, Lutfi Shala kryetar, Vesel Ismaili dhe Kujtim Krasniqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit Y.B për shkak të veprave penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK-së, dhe Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.39/2014, të datës 25.10.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i hapur për publikun, ku prezentë ishin Prokurori i Prokurorisë Speciale Fikrije Fejzullahu, i akuzuari Y.B dhe mbrojtësja e tij, av. K. K. nga Prishtina, gjykata me datë 16.01.2023, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Y.B nga i ati R. dhe nënës M., e gjinisë R., me nofkën "H. K." i lindur më, në K. ku edhe jeton rruga "D. B." Nr..., me numër personal, i ati i tre fëmijëve ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet ne masën e paraburgimit prej dt.28.05.2022.

I.

ËSHTË FAJTOR

I. Sepse me qëllim të bashkëngjitjes organizatave terroriste, në Mars të vitit 2013, me dashje, me vetëdije të plotë duke qenë në dijeni që veprimi i tillë është i kundërligjshëm, ka marrë pjesë në veprimtarinë terroriste në atë mënyrë që e ka lëshuar vendbanimin e përhershëm të tij në Republikën e Kosovës dhe ka udhëtuar nga aeroporti i P., "A. J.", për në T., e pastaj përmes Republikës së T. ka udhëtuar drejtë shtetit të S. në qytetin I., ku janë takuar edhe me shqiptarë dhe persona tjerë nga vendet të ndryshme dhe ka filluar ushtrimet ushtarake me qëllim që të merr pjesë në luftime në kuadër të organizatës terroriste A. "D. I.", e cila më vonë është njohur si ISIS, organizatë kjo e shpallur, organizatë terroriste nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, ku ka qëndruar deri me datën, ku edhe është kthyer nga S. në K..

-Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 41, 42, 43, 45, 73, 74,83, të KPRK-së, si dhe nenit 360, 361 dhe nenit 365 dhe ne nenit 367 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit **Y.B** e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 5 (pesë) vite**, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës **28.05.2022** e deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar.

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompenzon shumën prej **200 euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **100 euro**, si dhe në emër të fondit për kompensim të viktimave shumën prej **100 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me aktvendim të veçantë PS.nr.42/22 të datës 16.01.2023, gjykata të akuzuarit ia ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.

II.

Në kuptim të nenit 363 par.1, nën par. 1.1. të KPPRK-së, ndaj të akuzuarit **Y. B.**

REFUZOHET KATAKUZA

Gjatë viti 2013, i pandehuri me dashje ka siguruar burime materiale për persona të tjerë me qëllim të mundësimin të bashkëngjijtes në grup terrorist në S., në atë mënyrë që i njëjti paraprakisht kishte siguruar dy bileta aeroplani, njëren për veti e tjetrën për F. D., për çka kishte paguar nga 101 euro, për biletë përmes kompanisë P., ashtu që i njëjti kishte udhëtuar për në Siri bashkë me F. D. dhe persona tjerë.

-Me këtë kishte për të kryer veprën penale Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së.

Për shkak të tërheqjes së Prokurorit të Prokurorisë Speciale.

Për pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pran kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PPS.nr.39/2014, të datës 25.10.2022 kundër të akuzuarit **Y. B.**, për shkak të veprave penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK-së, dhe Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së,

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 08.11.2022 aktakuza PPS.nr.39/2014, të datës ... është lexuar dhe elaboruar nga prokurorja e PSRK, e cila ka përmirësuar kualifikimin juridik të veprës penale për pikën II të aktakuzës, në vend të rekrutimit për terrorizëm nga neni 139 par.1 të KPRK-së, në veprën penale Financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së. I akuzuari në këtë seancë është deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti Special në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datë 11.01.2023 ku prezent ishin Prokurori i Prokurorisë Speciale Fikrije Fejzullahu, i akuzuari Y.B dhe mbrojtësja e tij av. K. K..

Prokurorja e Prokurorisë Speciale në këtë shqyrtim gjyqësor ka deklaruar sa i përket dispozitivit II të aktakuzës **heq dorë nga ndjekja penale**, pasi që pas vlerësimit të provave rezulton aktakuza është ngritur mbi bazën e deklaratës së F.D. i cili është dëgjuar në cilësinë e të dyshuarit. Andaj në kuptim të dispozitës

se nenit 52 të KPPRK-së sa i përket dispozitivit II të aktakuzës është tërhequr nga ndjekja penale konkretisht për veprën penale Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së, ndërsa ka qëndruar pranë aktakuzës për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK-së.

Gjykata pas leximit të aktakuzës nga PRSK-së, dhe heqjes dorë nga ndjekja penale për pikën II të dispozitivit të aktakuzës i dha mundësin të akuzuarit që të deklarohet për fajësinë për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari Y.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se pasi që Prokuroria Speciale u tërhoq nga pika II e aktakuzës, konkretisht për veprën penale Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit nga neni 131 par.1 të KPRK-së, ndërsa për pikën I të dispozitivit konkretisht për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPRK-së, ka deklaruar me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, se ndjen vetën fajtorë.

Mbrojtësja e të akuzuarit Y.B v. K. B. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, pasi ky pranim i fajësisë ka ardhur si rezultat i konsultimit të mjaftueshme, duke i kuptuar të gjitha pasojat dhe bene fitet që i nënkupton pranimi i fajësisë.

Prokurorja e Prokurorisë Speciale Fikrie Fejzullahu në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se mbështet pranimin e fajësisë nga i akuzuari Y.B pasi që ky pranim gjen mbështetje në provat e bashkangjitura aktakuzë.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se i njëjti ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat materiale të prezantuara nga Prokuroria Speciale.

Trupi gjykues vlerëson se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë behet vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, materialet e prezantuara nga Prokurori e Shtetit e që janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale cilat i vihet në barrë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklaratimet e pranimit të fajësisë nga i akuzuari dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i akuzuari, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i akuzuari e ka pranuar si të tillë.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë dhe gjykata me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë, shqyrtimi gjyqësor vazhdoi me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e Prokurorisë Speciale Fikrie Fejzullahu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: i akuzuari Y.B në deklarimin e tij të sotëm e pranoi fajësinë sipas aktakuzës konsiderojmë se ky pranim fajësisë është në përputhje të plotë me të gjitha provat e propozuara për administrim në gjykatë, i cili pranim gjithashtu rezulton nga fakti që i njëjti që nga fillimi është i mbrojtur nga mbrojtja zyrtare me mundësi të konsultimit prej fillimit të hetimit. Bazuar në këtë Prokuroria Speciale nuk e shihet të arsyeshme të lëshohet më tutje për faktin se u pranua fajësia, megjithatë për kundër faktit që pranimi i fajësisë sipas Kodit ka edhe benefitet e veta. E njëjta i ka propozuar gjykatës që në rastin konkret të peshohen jo vetëm rrethanat lehtësuese që sigurohen nga pranimi i fajësisë por edhe rrethanat faktike që në këtë rast e rendojnë të akuzuarin. Në veçanti qëndrimi i tij i gjatë në zonat e luftës në S.dhe kthimi jo i vullnetshëm i tij në Republikën e Kosovës nga S.. Vet kohëzgjatja e qëndrimit të tij në një zonë lufte vërteton qartë

faktin se i njëjti në vazhdimësi ka ndërmarrë veprime terroriste që si dukuri globale qe paraqet rrezik të ashpër për shoqërinë.

Mbrojtësja e të akuzuarit Y.B av. K. K.në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: duke u bazuar në ligjin lidhur me pranimin e fajësisë, për benefitet e pranimit të fajësisë, ka kërkuar nga gjykata që të merret parasysh qëndrimi i të mbrojturit të saj, në B. e S. nga data ... deri me datën Gjithashtu të merret parasysh e kaluara para shkuarjes në Siri që do të thotë që nuk ka pasur asnjë vepër tjetër penale për të cilën është akuzuar më parë. E njëjta i ka propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të saj ti shqiptohet një dënim sa më i arsyeshëm.

I akuzuari Y.B .në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: se e mbështet fjalën përfundimtare të të mbrojturës se tij, duke theksuar se pendohet për këto veprime se nuk do ti përsëris më kurrë këto veprime, jam baba i tre fëmijëve. Po ashtu ka theksuar se prej datës ... deri me datën ..., ka qenë i paraburgosur në burgun e Ushtarak të Forcave Demokratike Siriane.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin ka gjetur; **pranimin e fajësisë**, pasi që i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë, e pranon se ka kryer veprën penale, është penduar, dhe premtun se në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale; **rrethanat personale dhe karakterin e personit të dënuar**, të njëjtin shkaktimi i kësaj veprë në masë të madhe e ka lënduar shpirtërisht edhe vet atë; **keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar, moshën e personit të dënuar** i njëjti është i moshës së re, **bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën** pasi që i njëjti ka pasur sjellje korrekte në gjykatë dhe me organet të tjera të drejtësisë, faktin se i njëjti nuk kemi të dhëna se ka qenë i dënuar më parë.

Gjykata gjithashtu duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit, ka gjetur; **shkallën e lartë të pjesëmarrjes**; ka marrë pjesë në veprimtarinë terroriste e ka lëshuar vendbanimin e përhershëm të tij në Republikën e Kosovës dhe ka udhëtuar drejtë shtetit të Sirisë në qytetin Idlib, **shkallën e lartë të dashjes**; me dashje, me vetëdije të plotë, ka filluar ushtrimet ushtarake dhe ka marrë pjesë në luftime në kuadër të organizatës terroriste A...“D. I.”, të njohur si ISIS; **rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur** siç rezulton kjo vepër penale ka synim ruajtjen e shoqërisë nga ndjenja e frikës dhe pasigurisë si pasojë e akteve terroriste, pasi që të njëjtat janë të drejtuara në rrezikimin e jetës, integritetit trupor, liritë themelore rendit juridik dhe të vlerave ndërkombëtare, ndërsa rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me këtë dënim, është e bindur se do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPK-së, dhe atë duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet, qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës individuale, të ta parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës gjeneralë.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit, në dënimin e shqiptuar gjykata e ka mbështetur në nenin 83 të KPK-së. Po ashtu kjo gjykatë nuk ka pasur shkresa-prova se i akuzuari te ketë qenë i paraburgosur në burgun e Ushtarak të Forcave Demokratike Siriane, qe të njëjtit ti llogaritet paraburgimi në dënimin e shqiptuar, edhe pse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka njoftuar gjykatën se nga dt:.....deri më dt:, ka qenë nën masën e paraburgimit në Burgun Ushtarak të Forcave Demokratike në S...

Vendimin lidhur me vazhdimin e masës së paraburgimit deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar, gjykata e ka mbështetur në nenin 367 par.1 nën par.1.1 dhe par. 7 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 të KPPK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 dhe nenit 363 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti Special-
PS.nr.42/2022, me datën 16.01.2023

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Lutfi SHALA

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit - Departamenti Special në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore - Departamenti Special në Prishtinë.